



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT

MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK



**Republika e Kosovës,
Kuvendi i Komunës së Junikut,
Numër: 02/11,
Datë: 02.6.2014 .**

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008) dhe nenit 22.1 paragrafi 4 të statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26), **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 30.5.2014 nxjerrë:

Vendim

për

formimin e Grupit të Femrave të komunës së Junikut

I. Me këtë vendim formohet Grupi i Femrave të komunës së Junikut/në tekstin e mëtejme Grupi i Femrave/.

II. Grupin e Femrave përbëhet nga 11 anëtare si në vijim:

- a) anëtares femra të Kuvendit të Komunës së Junikut (6),
- b) zyrtarja për barazi gjinore e Komunës së Junikut (1),
- c) një (1) përfaqësuese nga shkollat (SHFMU "Edmond Hoxha" dhe Gjymnazi "Kuvendi i Junikut),
- d) një (1) përfaqësuese nga QMF "Dr. Ali Hoxha",
- e) një (1) përfaqësuese nga Komuniteti i Biznesit, dhe
- f) një (1) përfaqësuese nga OJQ-të.

III. Anëtares nga paragrafët c), d), e) dhe f) të pikës II. të këtij vendimi duhet të delegohen nga subjektet përkatëse brenda 30 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi

IV. Për mbarëvajtjen e punës së Grupit të Femrave e njëjta harton: planin e punës (strategjinë) dhe raportin e punës.

V. Projekt dokumentet nga pika IV. e këtij vendimi i procedohen kuvendit të komunës për shqyrtim dhe miratim.

VI. Grupi i Femrave është organ këshillëdhënës, kurse për punën e tij i përgjigjet Kuvendit të Komunës.

VII. Mbledhjet e Grupit të Femrave i udhëheqë kryesuesja e cila do të zgjedhet në mbledhjen inauguruese.

Adresa:

Tel.: +386 (0) 49 760 270

<http://rks-gov.net/junik>

VIII. Kryesuesja e Grupit të Femrave zgjedhet sipas nenit 8 paragrafi 8.7 të rregullores për punën e komiteteve të Kuvendit të Komunës së Junikut.

IX. Mandati i Grupit të Femrave është i njëjtë me mandatin e kësaj legjislature të Kuvendit të Komunës.

X. Procedura e zëvendësimit apo shkarkimit eventual të ndonjë anëtareje të Grupit të Femrës bëhet sipas procedurës së njëjtë të miratimit në Kuvendin e Komunës.

XI. Procedura e ndryshimit të këtij apo ndonjë dispozite të këtij vendimi është e njëjtë me procedurën e miratimit.

XII. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen vendimet tjera me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

XIII. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga ana e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Junikut dhe shqyrtimit të ligjshmërisë nga ana e Departamentit Ligjor të MAPL-së.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL,
2. shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut, dhe
3. arkivi i komunës së Junikut.

Kuvendi i Komunës së Junikut

Faik TOFAJ _____
kryesues